

E SHTUNA E SHEN THEODORIT

Në Mëngjes pas Gjashte Psalmeve këndohet:

PERLESHORJA E SHEN THEODORIT, T. II.

MEGALLA TA TIS PISTEOS

Çudira të mëdha bes' e fortë po mbaron: Në furrë dhe nëpër zjarr, si nëpër ujëra të fladitura, gëzohej Dëshmori i Shenjtë Theodor' i Math; u-dog në zjarr si hollokost, si buk' e bekuar për Zotin në qjell u-shpu. Dhe ay po të lutet o Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

NDENJESORET, T. III.

PAS THIAS PISTEOS

Besëdjegur i Orthodoxisë, shove rejtjen e kadoxisë, dhe dërmovë paganizmën dhe idhullat, edhe i tëri u-dogje si hollokost, dhe na gëzove me shenja dhe me çudi, o Dëshmor me nam, iu-lut Jesu Krishtit Perëndi, për ndjesën e besnikëve.

LAVDI: Një dhuratë je prej Perëndisë, për lëngonjësit e tërë botës, se të forcoj midis rezikeve Zot i Math; dhe na shërove sëmundjet e shpirteve, dhe na i shove pësimet e trupeve. O Shën Theodor, iu-lut Jesu Krishtit Perëndi, për ndjesën dhe shpëtimin e besnikëve.

TANI: Zonjë Shën Mari, banes' e fjalës, Nën' e Zotit Krisht, o Virgjëreshë, që kapërcen nga bukuria gjithë Engjëjtë, na shiko dhe na shpëto ne që të lutemi, se prej mëkatave të zeza po mbytemi. Birit pra iu-lut, o Zonjë Mari Hyjlindëse, për ndjesën dhe shpëtimin e besnikëve.

Pastaj Psalmi 51 pa zë, dhe menjëherë:

SHKURTORJA, T. T. IV.

Besën dhe forcën e Zotit Krisht, pate në zëmër posi shqyt, edhe poterat e djajve i dërmovë o Shën Theodor, dhe more lart në qjell kurorën, si Athlofor i pamundur.

SHTEPIA

Ty që rri mi fronin e dritës, të hymnojmë dhe të përhirojmë me besë, se na dhurove Kryetarin Shën Theodor, i cili u-lumërua në jetë, se mproj të vërtetën, dhe mori lart në qjell kurorën, si Athlofor i pamundur.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Shtunën e Javës së parë të Kreshmëve, kremtojmë çudinë e grurit, që bëri Shën Theodori, Dëshmori i Math i lavdëruar i Tironit.

Me nërmjetimet e tij, o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

ZBRITESORET, T. IV.

ANIKSO TO STOMA MU

I. Ja gojën e çel tani, i frymësuar prej Shpirtit Shenjt, dhe këngë do t'i këndonj, Nënës së Madhe mi fron, dhe do ta kremtonj me valle buzëqeshur, me zë do t'i çpall kudo, gjithë çudit' e saj.

III. O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur paqësor, ti paqësoji gjith' ata, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qjell ku mbretëron, kurorëzoji me çdo lavdi.

IV. Ti që rri midis lavdisë, përmi fronin e hyjshëm, nga një re e lehtë, ardhe o Jesu i përjetëshëm, dhe na shpëtove me dorën jetëdhënëse, të thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithënjë mi ty.

V. Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjëresh' e pamartuar, Zotin e jetës që mbretëron lart në qjell, si një bir e mbajte në pëqi, dhe shpëtim që lartazi, u dhurove besnikëve.

VI. Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënë Hyjlindëse, gjithë hyjmëndësit, eni trokisni pra duartë, dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj.

VII. Nuk u falëshin krijesave hyjmëndësit, po Krijetarit lart, dhe kërcënimin me zjarr, e shkelnë me trimëri, psallnin me brohori: Zot lavdi më ty, o Perëndi i Atërve, ti je vetëm i bekuar.

VIII. Djemat e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si vepërim tani, dhe tërë botën po e mbleth, për këng' e lavdërim: Hymnojeni ju veprat e Zotit, dhe e lartësoni përmi të gjitha jetët.

IX. Gjithë njerëzit, këceni me ngazëllim, tek drit'e Shpirtit Shenjt, eni lavdërojeni, Engjëjt' e qjellit, eni kremtojeni, këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Mari, dhe thërrisni: Ti je më e lumura, Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.

DERGIMESORET, T. II.

PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Kurorë more ti o Shenjt, dhe rri tani si Engjëll, përpara Zotit Jesu Krishtit, dhe me dritën e qjellit, o Athlofor i shkëlqyer, nërmjeto pa pushuar, për ndjesën e mëkatave, edhe falna shpëtimin për gjithënjë, në Parajsën shpjerna tok me të drejtët, o Theodor o Shenjt me nam, Dëshmor i Math i lumur.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bërë, na përsërite shpirtin, të prishur prej mëkatave, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra të thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen katër të Tingëllit edhe katër të Përsëmbëllta të Triodit më Tingëllin I:

PAS TON URANION TAGMATON

Eni të gjith' o besnikë ta lavdërojmë sot, me besë dhe me zëmër, dhe me këngë mistike, të madhin gjeneral të Engjëjve lart, le t'i lutemi pa pushim: Shën Theodor çudibërës Dëshmor i Math, nërmjeto për të gjithë ne.

Pas emrit tënt të bekuar dhurat' e Zotit je, gëzim në hidhërimet, dhe shërim në sëmundjet, mëshirë dhe shpëtim për çdo mëkatar, gjithënjë pra të lutemi: Shën Theodor çudibërës Dëshmor i Math, nërmjeto për të gjithë ne.

Mi dhenë mblodhe thesare për Zotin Krisht në qjell, me vojtje dhe mundime, dhe u-dogje i tërë, temjan i mirëpritur flag' e kurban, përandaj po të lutemi: Shën Theodor çudibërës Dëshmor i Math, nërmjeto për të gjithë ne.

Në panairin e shenjtë që po kremtojmë sot, me besë dhe me shpresë, dhe me valle mistike, me këngë dhe dëfrime o Athlofor, dhe me mall po të lutemi. Shën Theodor çudibërës Dëshmor i Math, nërmjeto për të gjithë ne.

LAVDI, T.T. IV. Dhuratë shenjtërimi, dhe pasuri e perëndishme, u-çfaqje për botën o Shën Theodor. Përandaj Krishti ta lavdëroj, kujtimin e shenjtë o Dëshmor i Math, edhe besnikët me një zë, hymnojnë vojtjet edhe dëshmimet e tua.

TANI. Ti je vreshta e vërtetë o Hyjlindëse Mari, se ti linde pemën që jetë na fal, dhe ty të lutemin: Eja dhe nërmjeto, me gjithë Athloforët, dhe bashkë me Shenjtorët, që të shpëtojmë prej mëkatave.

Doksollogji e Madhe. Në Hyrjen këndohet:

PERLESHORJA E SHEN THEODORIT, T. II. MEGALLA TA TIS PISTEOS

Çudira të mëdha bes' e fortë po mbaron: Në furrë dhe nëpër zjarr, si nëpër ujëra të flladitura, gëzohej Dëshmori i Shenjtë Theodor i Math; u-dog në zjarr si

hollokost, si buk'e bekuar për Zotin në qjell u-shpu. Dhe ay po të lutet o Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtet tona.

Përlëshorja e Shenjtit të Kishës. Pastaj:

SHKURTORJA, T. IV. PROSTASIA TON KHRISTIANON

O mburonj' e patronditur e të Krishterëve, nermjetare e palodhur e besnikëve, vër-u veshin mëkatarëve me dhëmpshëri, se po të thërresim besërisht, o Nën' e Zotit Krisht, o Mari Virgjëreshë: Ndhina me nermjetimet, dhe lutjet mëshirëplote, dhe mpro përherë gjith' ata, që të lusin o Hyjlindëse.

APOSTULLI

I drejti do të gëzohet më Zotin.

Dëgjo-ma lutjen, o Perëndi.

Këndimi prej Letrës II për Timotheën.

Bir Timothe, forcohu me hirin e Zotit Krisht. Edhe ato, që ke dëgjuar prej meje midis dëshmorësh të shumë, ua dorëzo njerësve besnikë, të cilët janë të zotët tua mësojnë edhe të tjerëve. Ti pra duroji të këqiat, si një ushtar i mirë i Jesu Krishtit. Asnjë ushtar, që shkon në luftë, nukë ngatërrohet me andrallat e kësaj jete, që kështu t'i pëlqenjë kumandarit, që e mori ushtar. Edhe ay, që merr pjesë në konkurset, nuk e fiton kurorën, veçse kur i mban regullat. Bujku, që punon, duhet ta marrë pjesën e pemëve i pari. Mejtoji këto, që të them; edhe Zoti të dhëntë urtësi për të gjitha. Kujto, që Jesu Krishti nga fara e Davidit u-ngjall prej së vdekurësh pas Ungjillit tim, për të cilin po vuanj si keqbërës gjer në burk, po fjala e Perëndisë nukë burgoset. Përandaj

i vuanj të gjitha për të zgjedhurit, që ta trashëgojnë dhe ata shpëtimin e Jesu Krishtit me lavdinë e ameshuar.

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u tha Dishepujve: Unë jam vreshta e vërtetë, dhe im-Atë është bujku. Çdo hardhi, që nuk bën pemë për mua, e çkul; edhe çdo hardhi, që sjell pemë, e qëron, që të sjellë më tepër pemë. Ju jini të qëruar me fjalën, që ju kam folur. Qëndroni tek unë, dhe unë tek ju. Sikundër hardhia nukë munt të sjellë pemë prej vetiu, në mos qëndroftë në vreshtë, ashtu nukë muntni as ju, në mos qëndrofshi tek unë. Unë jam vreshta, ju jini hardhitë. Ay, që qëndron tek unë, dhe unë tek ay, ay siell shumë pemë; se pa mua nukë muntni të bëni asgjë. Ay, që nukë qëndron tek unë, nxiret jashtë si hardhia, dhe thahet, edhe e mbledhin, dhe e hedhin në zjarr, dhe e djegin. Në qëndrofshi tek unë, dhe në qëndrofshin fjalët e mia tek ju, çdo gjë që të lypni, do tju bëhet.

Në "Veçan tërëshenjtën," këndohet:

AKSION ESTIN

Ti me të vërtetë meriton, lavdërime ti o Virgjëreshë: Ti je më e lumura, dhe më e ndriçimja, ti je Nën' e Zotit Jesu Krisht; ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përjasje mi Serafim; ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

KUNGATORE

Kujtimi i të drejtit do të jetë i përjetmë. Alilluia, alilluia, alilluia.